

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Zyhdi Haziri, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale të akuzuarit H.M., nga Gjilani, rr. “ ... ” nr. ..., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 1206/17 të datës 25.07.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datën 22.10.2018 bie dhe në prezencë të palëve publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari H.M., nga i ati S., dhe nëna E., e lindur M., i lindur me datë ... në Gjilan ku edhe jeton rr.” ... ” nr. ... i pa martuar, i pa punë, student, i gjendjes së mesme ekonomike Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë 09.07.2017, rrethe orës 03,00 në rrugën “15 Qershor” në Gjilan në drejtim të udhëkryqit me rrugën Prishtinës i pandehuri H.M. duke drejtuar automjetin për pasagjer të markës “Audi A6” me tabela ... ka rreziku trafikun publik duke vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, e në kundërshtim me nenin 64 të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor të Kosovës, ka bërë vozitje të pakujtdesshme, në atë mënyrë që me të arritur saktësisht në urdhkryq – kryqëzim i rrugës “15 Qershori” rruga “Medllin Ollbrajt” me rrugën “Nëna Terezë” dhe në me rrugën “Pajazit Ahmeti” në Gjilan, duke mos rrespektuar shenjën “Stop” dhe përparësinë e kalimit në udhëkryq për automjetet që lëvizin nëpër rrugën kryesore, e trupon rrugën e Prishtinës rrugën kryesore në drejtim të rrugës “Pajazit Ahmeti” në mënyrë të pasigurt, pa u bindur më parë se këtë veprim mund ta bëjë pa i penguar dhe rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në trafik, ku me këtë rast me pjesën e përparme të majtë e godet në anësoren e pasme të majtë automjetin për pasagjer të markës “VW Pasat” me tabela ... me vozitës A.S., i cili ishte duke lëvizuar nëpër rrugën kryesore rrugën e Prishtinës në drejtim të qendrës së Gjilanit ku si pasojë e këtij aksidenti, përveq dëmeve materiale të shkaktuara në dy veturat lëndime të lehta trupore pëson vozitësi i automjetit “VW pasat” A.S. i cili si pasojë e lëndimeve ka kërkuar trajtim mjekësor në Qendrnën Emërgjente në Gjilan, sipas raportit mjekësor me nr. protok. 14171 të datës 09.07.2017.

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Me çka ka kryer veprë penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 7, 17, 43, 51, 73, 114 të KPRK-së, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së.

Ndaj të akuzuarit H.M. shqiptohet

DËNIMI ME KUSHT

Të akuzuarin i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj burgim, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

I dëmtuari A.S., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të viktimës së krimit të paguaj shumën prej 30 (tridhjet) euro.

Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 15 (pesëmbëdhjet) euro, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti për Krime të Përgjithshme, me datë 25.07.2017, ka paraqitur aktakuzë PP.II.nr. 1206/2017, kundër të akuzuarit H.M., nga Gjiilani, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim meritore.

Në seancën fillestare të datës 22.10.2018 i akuzuari H.M., e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vëhet në barrë sipas aktit akuzues.

Ndërsa në fjalën përfundimtare prokurori I shtetit Kujtesa Fazliu, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit H.M., të shpallet fajtor për kryerjen e veprës penale dhe ndaj tij të shqiptohet një dënim meritore sipas KPRK-ës.

I akuzuari H.M., gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se më vjen shumë keq për këtë veprë penale, me të dëmtuarin jemi pajtuar që nga dita kur ka ndodhur ndeshja, në të ardhmen do të jemi më i kujdesshëm, dhe kërkoi nga gjykata që të më shqiptoi një dënim sa më të but dhe i premttoi gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra tjera penale.

2. Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjatë seancës gjyqësore i akuzuari H.M., nga Gjilani ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi aktakuzën e lartëcekur dhe veprën penale për të cilat akuzohet duke shtuar se e pranoi fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjykatësi I vetëm gjykues pas dëgjimit të të akuzuarit, ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se i akuzuari i ka kuptuar edhe natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza nuk përmbajnë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar dhe vendimi për shpalljen fajtor të të akuzuarit.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykatësi I vetëm gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari H.M., e ka kryer veprat penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit.

Si rezultat i kësaj gjendje të vërtetuar faktike, gjykatësi I vetëm gjykues ka vendosur që ta shpallë fajtor të akuzuarin H.M., për kryerjen e veprave penale të lartëcekura, ngase ka ardhur në përfundim se me veprimet e tija përmbajnë të gjitha elementet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është penalisht përgjegjës.

4. Elementet e veprës penale

Sipas veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, dhe kjo vepër kryhet me dashje dhe nga pakujdesia dhe kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor duke rrezikuar jetën e njerëzve apo pasurisë e duke shkaktuar lëndime të lehta trupore apo dëm pasuror dhe konform dispozitave ligjore për këtë vepër mund të shqiptohet dënimi ndaj kryerësit me gjobë ose me dënim burgu deri në tri vite.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Me rastin e shqiptimit të dënimeve ndaj të akuzuarit, gjykatësi I vetëm gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësin e dënimit sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK-ës. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit H.M.; se ka marrë për bazë moshën e tij të re, se i akuzuari është penduar për kryerjen e veprave penale, si dhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, si rrethanë rënduese, Gjykata e ka marrë për bazë lëndimet trupore të të dëmtuarit.

6. shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprave penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Sipas bindjes së Gjykatës, dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit H.M., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është denim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit. Me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht.

Kështu që Gjykata për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me kusht edhe ate me dënim burgu në kohëzgjatje prej 4. (katër) muaj) i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Gjykata gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK-ës, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen. të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke u bazuar në natyrën e kësaj çështje penale, gjykatësi I vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 451 par.1. të KPPK-ës ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ti paguar shpenzimet e procedurës që dalin sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, dhe Obligohet i akuzuari që ti paguaj 15. (pesëmbdhjet) euro në emër të paushallit gjyëqosr si dhe të paguaj 30 (tridhjet) euro në emër të viktimave të krimit të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 754/2017 Me datë: 22.10.2018**

Sekretarja Juridike
Naile Neziri

Gjyqtari I vetëm gjykues,
Zyhdi Haziri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krime të Përgjithshme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.